

DEKLARATË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shpreh shqetësimin dhe indignatën më të thellë për fatin e mijëra shqiptarëve të Kosovës të marrë peng në Serbi, gjatë fushatës së spastrimit etnik:

Duke konstatuar se nga e gjithë Kosova mungojnë pa gjurmë mijëra njerëz (vetëm nga Komuna e Gjakovës figurojnë të tillë mbi 720 vetë) dhe se autoritet serbe nuk bëjnë të njohur identitetin e personave të marrë peng;

Duke ditur se në burgjet dhe kampet serbe, pengjet shqiptare u nënshtrohen torturave fizike e psikike;

Duke marrë dijeni për dënimet me burgime të rënda të qindra njerëzve me procese kolektive, politike pa asistencë juridike dhe nën akuza tërësisht absurde;

Duke e konsideruar të gjithë këtë krim të rëndë ndaj njerëzimit, në vijim të krimeve të zbuluara në varrezat kolektive deri tani në Kosovë;

Duke ditur se, mbajtja, torturimi dhe dënimet me burgime të rënda të pengjeve shqiptare i shërben Milosheviçit për ndezjen e konflikteve etnike dhe destabilizimin e Kosovës dhe gjithë rajonit;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u kërkon Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe OSBE-së, të ushtrojnë autoritetin e tyre për fillimin e menjëhershëm të hetimeve mbi sa më sipër dhe të detyrojnë Beogradin;

Të japë të dhëna të plota për shqiptarët e marrë peng, të ndalojë proceset politike dhe të bëjë lirin e menjëhershëm të tyre.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ia drejton këtë deklaratë edhe Kongresit Amerikan dhe parlamenteve të Europës.

Kuvendi i kërkon Qeverisë Shqiptare të intensifikojë përpjekjet pranë qeverive të Bashkimit Europian dhe SHBA-së, si dhe pranë organizmave ndërkombëtarë për ndërhyrje të menjëhershme.

Tiranë, më 1 qershor 2000